



Republika e Kosovës  
Zyra e Kryeministrit  
Agjencia për Barazi Gjinore

## **Termat e Referencës**

për

**mentorimin e start – up bizneseve (përfitueset e granteve)**

**Projekti: Fuqizimi dhe Rimekëmbja Ekonomike dhe të drejtat e grave të mbijetuara nga dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale**

### **1. Zhvillimi i kapaciteteve**

#### **1.1. Prapavija**

Mbështetur nga Agjencia për Barazi Gjinore e Republikës së Kosovës, Medica Gjakova si organizatë partnere lokale, është përgjegjëse për implementimin projektit "Fuqizimi dhe Rimekëmbja Ekonomike dhe të drejtat e grave të mbijetuara nga dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale", projekt ky i bazuar në administrimin e ndihmës së Masës 10-të, për Programin e Rigjenerimit Ekonomik në Republikën e Kosovës.

#### **1.2. Informata për projektin**

Kosova, posaqërsisht Rajoni i Dukagjinit është prekur nga papunësia e lartë dhe varfëria, veçanërisht në mesin e grave të mbijetuara të dhunës seksuale dhe vajzave (familjarët e tyre). Shumë prej tyre për shkak të stigmatizimit përballen me varfërinë, papunësin dhe diskriminimin përsëri e sidomos tani që për shkak të pandemisë Covid-19 gjendja ekonomike është rënduar tejmasë. Si një vend që ka përjetuar konflikt/luftë, dhuna në të gjitha format është përhapur shumë në Kosovë duke përfshirë edhe të rikthyerit. Projekti synon poashtu riintegrimin e qëndrueshëm të këtyre personave duke mundësuar kështu edhe fuqizimin dhe stabilizimin e Kosovës. Projekti do të ndihmojë përmes sektorit për fuqizim ekonomik (gjenerimit të të hyrave dhe zhvillimit të kapaciteteve), psikosocial (kshillimeve), gjinekologjik (kshillimeve dhe vizitave) dhe juridik (kshillimeve dhe asistences).

Grupi i targetuar i synuar do të jetë 130 persona të cilët janë gra/vajza të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe të rinjë familjarë të tyre të cilët kanë përjetuar traumë ndër gjenerata. Deri në 10% do të jenë persona të rikthyer, veçanërisht gratë dhe pakicat etnike.



Republika e Kosovës  
Zyra e Kryeministrit  
Agjencia për Barazi Gjinore

Grupi i ndikuar indirekt do të jenë familjarët e grupit të targetit që do të përfitojnë nga rritja e të ardhurave (rreth 1500 persona).

## 2. Qëllimi i marrëveshjes

Ofruesi i shërbimit është përgjegjës të bashkëpunojë ngushtë me Medica Gjakova, në Gjakovë, për të siguruar këshillim dhe mbështetje për 15 biznese fillestare për të pasur sukses në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregje.

Medica Gjakova do të sigurojë që kompania këshilluese të ketë qasje të përshtatshme për shkak të ndjeshmërisë së grupit të synuar.

Ofruesi i shërbimit do të punojë ngushtë me Medica Gjakova për të kryer detyrat e mëposhtme:

Aktiviteti 1: Mentorimi / Trainimi i 15 bizneseve fillestare (11 biznese fillestare për rrobaqepësi, 2 biznese fillestare për kuzhinë dhe 2 biznese fillestare për floktari);

Kompania këshilluese supozohet të caktojë mentorë deri në katër (4) për 15 gra (përfituese të granteve) gjatë procesit të fillimit të biznesit të tyre në fusha të ndryshme. Mentorët duhet të kenë përvojë në fusha të ndryshme duke përfshirë rrobaqepësinë fillestare/industriale, parukerinë, kuzhinën, marketingun, menaxhimin e financave dhe çdo fushë tjetër kur paraqiten nevojat. Katër mentorë do të punojnë në koordinim të ngushtë dhe do t'i raportojnë Medica Gjakova.

## 3. Shërbimet

Ofruesi lokal i shërbimit do të jetë përgjegjës për produktet e mëposhtme:

- Lista e mentorëve që do të mentorojnë përfituesit (Shënim: mentorët duhet të jenë vetëm gra);
- Raport i shkurtër mbi vlerësimin e nevojave të përfituesve dhe planifikon se si të adresohen këto nevoja.
- Marrëveshja për mentorim e nënshkruar ndërmjet mentorëve dhe të mentoruarëve.
- Regjistri i punës së mentorëve ndërsa mentorët kryejnë mentorimin e tyre;
- Çdo mentor do të sigurojë raport të shkurtër të mentorimit për çdo biznes fillestar (përfituesit e granteve) veç e veç. *Shënim: raporti duhet të përmbajë situatën para dhe pas të fillimit të bizneseve, fotografi (në përputhje me kërkesat e Medica Gjakova) dhe informacione të tjera të nevojshme për të provuar progresin e fillimit të bizneseve.*



Republika e Kosovës  
Zyra e Kryeministrit  
Agjencia për Barazi Gjinore

- Raporti përfundimtar brenda 15 ditëve nga përfundimi i detyrës, përfshirë rekomandimet dhe konkluzionet e mësimëve të mësuara;

#### **4. Orari**

Detyra duhet të përmbushet gjatë 3 muajve, në varësi të nevojës, përkatësisht duke filluar nga korriku 2021. Gjatë kësaj periudhe, ofruesi i shërbimit do të kryejë detyrat siç janë përshkruar më sipër.

#### **5. Gjuha**

Këshillimi do të bëhet në gjuhët lokale.

Raporti i shkurtër i progresit duhet të shkruhet në gjuhën shqipe.

Raporti përfundimtar duhet të shkruhet në gjuhën angleze.

#### **6. Vendi ku do të bëhet marrëveshja**

Gjakova, Klina, Skenderaj, Drenoc, Junik dhe Peja, Republika e Kosovës.

#### **7. Raportimi**

- Dorëzimi i raportit të progresit dhe raportit përfundimtar siç është rënë dakord.
- Dorëzimi i fotografive gjatë vizitave të mentorimit.
- Raportimi dhe të gjitha dokumentet e vlerësimit duhet të kryhen në gjuhët e përmendura më sipër. Komentet dhe sugjerimet nga ekipet e projektit MGJ duhet të merren parasysh gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

#### **8. Prokurimi i Pajisjeve dhe Materialeve**

Nuk aplikohet.

#### **9. Dispozita tjera**

Buxheti për shërbimin nuk duhet të kalojë shumë prej 1500 Euro vlera bruto dhe pagesa do të bëhet në dy këste.



Republika e Kosovës  
Zyra e Kryeministrit  
Agjencia për Barazi Gjinore

## 10. Kërkesa për informacion për ofertën

### 11.1 Ofruesi i Shërbimit duhet të dorëzojë:

a Propozimi teknik (plani i aktiviteteve dhe justifikimi që zgjedhjet e propozuara plotësojnë kërkesat e TOR)

b CV-të e drejtuesit të ekipit dhe të gjithë mentorëve që do të angazhohen në ofrimin e mentorimit.

*Shënim: Medica Gjakova rezervon të drejtën të konfirmojë dhe propozojë mentorë të tjerë në përputhje me rrethanat.*

c Propozimi i Buxhetit

**11.2.** Dëshmi e statusit ligjor të ofruesit të shërbimit (regjistrimi dhe / ose dokumentacioni i certifikimit), detajet e kompanisë (emri, adresa postare informacioni i bankës, etj.) dhe letërnjoftimi i pronarit / drejtorit ekzekutiv.

**11.3.** Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë emrat e 3 klientëve referues me të cilët ata kanë ofruar një punë të ngjashme në të kaluarën siç kërkohet nga Medica Gjakova. Kompania / OJQ-ja duhet të ketë parasysh që të referencat mund të kontaktohen nga Medica Gjakova në çdo kohë.

Kompania / OJQ-ja duhet të paraqesë ofertën në gjuhën angleze.

## 11. Komunikimi

Nëse keni pyetje shtesë në lidhje me Termat e References ose procesin e tenderimit, ju lutem kontaktoni përmes emailit: [medicagjakova@hotmail.com](mailto:medicagjakova@hotmail.com) ose [laura.qarkaxhija@gmail.com](mailto:laura.qarkaxhija@gmail.com) (menaxhere e projektit).

Afati i fundit për dorëzimin e propozimit/ofertës është 30.07.2021.

Ofertat elektronike të plotësuara duhet të dorëzohen përmes postës elektronike në [medicagjakova@hotmail.com](mailto:medicagjakova@hotmail.com) ose [laura.qarkaxhija@gmail.com](mailto:laura.qarkaxhija@gmail.com) (menaxhere e projektit).

Shënim: Ofertat e marra pas afatit dhe ofertat jo të plota nuk do të mirren parasysh.